



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE

(Pasqyra 14 Sh)

DEKSI

SHTATOR 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet ne pasqyrën ne formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 te çdo muaji. Te dhënat e agreguara te pasqyrës 14 sh për muajin Shtator janë te dhënat e raportuara nga te 36 rrethet e vendit.

1. Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit Shtator 2018 zënë 50.48% te totalit te sëmundjeve infektive te raportuara me ane te Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidencë 330.13/100.000 banorë. Peshën kryesore ne grupin e sëmundjeve diarreike për muajin Shtator e mbajnë gastroenteritet e paspecifikuara dhe helmimet ushqimore me një incidencë përkatësisht 318.48/100.000 banorë dhe 9.43/100.000 banore ne nivel kombëtar. Gastroenteritet e paspecifikuar dhe helmimet ushqimore kane nje shpërndarje gjeografike pothuaj në të gjithë vendin.

Në muajin Shtator është raportuar nje rast Tiifo abdominale, i konfirmuar nga laboratorikisht, , DRSHP ne Tirane mori masat përkatëse ne vatër. Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore te incidencës së Salmonelozës jotifoide me incidencë 1.20/10.000 banore dhe te gjitha rastet janë te konfirmuara.

Gjithashtu rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore te incidencës së Shigelozës ne nivel kombëtar përkatësisht me incidencë 2.05/10.000 banorë, ndjekur nga Kukësi, Kruja dhe Tirana perkatesisht me nga 2 raste dhe Vlora ka raportuar vetëm një rast.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike ne Shtator 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Shtator 2018	Incidenca Shtator 2018 (raste/100.000 banore)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.04
Salmonelozë	20	0.71
Shigelozë (Disenteri bacilare)	41	1.46
Dizenteri amebike	0	0


Toksikoinfeksione alimentare	264	9.43
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	8918	318.48
Semundje diarreike ne total	9244	330.13

2. Sëmundjet e EPI

2.1. Fruthi

Gjatë muajit Shtator 2018 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 31 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv vetëm 13 raste. Rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, në ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Shtator 2018



Peshën kryesore sipas shpërndarjes gjeografike të rasteve të dyshuara dhe të konfirmuara me fruth e mban Tirana dhe grup-mosha < 1 vjeç.

2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit shtator 2018 janë raportuar 19 raste me Tuberkuloz pulmonar dhe 5 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar, me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Grupmosha e prekur është ajo adulte. Nga 19 raste te suspektuara 10 janë te konfirmuar me Tuberkuloz pulmonar dhe shtate raste janë raportuar nga DRSHP Durrës. Nga 5 rastet me Tuberkuloz ekstrapulmonar te suspektuara vetëm një rast është i konfirmuar.

3. Zoonozat

Ne nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.25/100.000 banore. Shpërndarja gjeografike e rasteve është në rrethet Lushnjë, Librazhd, Gjirokastër, Kolonje, Pogradec dhe Berat. Ndërkohë gjatë kësaj periudhe janë suspektuar dy raste me Leptospirozë. Rastet janë raportuar nga Berati dhe Tirana. Ne muajin Shtator 2018 leishmania visceralis paraqet një incidence 0.07/100.000 banore në nivel vendi.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në shtator 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Gusht 2018	Incidenca Gusht 2018 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	7	0.25
Leptospirozë	2	0.07
Leishmania visceralis	2	0.07
Leishmania kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Ne raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit Shtator 2018 janë raportuar në total 25 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.89/100.000 banore) nga të cilat 16 raste janë Hepatite virale të paspecifikuar dhe 1 rast Hepatit viral akut A, 7 raste Hepatit viral B të konfirmuar dhe një rast me Hepatit viral as A as B.

Ne lidhje me HBV, 7 rastet i përkasin grupmoshave të ndryshme. Rastet me HBV të konfirmuar janë raportuar përkatësisht nga Kuçova (1 rast) dhe Tirana (6 raste).

5. Meningoencefalite

Gjate muajit Shtator 2018 janë raportuar ne total 4 raste me meningoencefalite përkatësisht nga Tirana dhe Durrësi. Rastet kane predominim ne grup moshen pediatrike krahasuar me moshën adulte. Vetem nje rast ka rezultuar meningit viral nga Durrësi dhe 2 raste meningite bakteriale jomeningokoksike janë raportuar nga Tirana dhe Durrësi.

6. Ethe hemorragjike

Gjate te njëjtës periudhe te vitit 2018 jane raportuar dy raste te dyshuar ethe hemoragjike perkatesisht nga Berati dhe nga Tropoja. Rastet kane qene te grup moshes 45-55 vje dhe ne raportin meshkuj me femra 1:1. Te dy rastet rezultuan negativ per Ethe Hemorragjike me Sindrom Renal dhe Kongo Krime , prane laboratorit te virologjise ne ISHP.

INSTITUTI I
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI